




Përkufizimi gjuhësor i

fjalës “Iman”:

Fjala “Iman” gjuhësisht domethënë: vërtetim dhe pranim.

Përkufizimi imanit sipas pasuesve të sunetit dhe xhematit është:

- Besim me zemër,
- shqiptim me gjuhë,
- veprim me gjymtyrë,
- shtohet me bindje ndaj Zotit, dhe
- pakësohet me mëkate ndaj Tij.

Shtyllat e imanit

Shtyllat e imanit janë gjashtë:

- Besimi në Allahun.
- Besimi në melekë.
- Besimi në Librat e Allahut.
- Besimi në të dërguarit e Allahut.
- Besimi në Ditën e Gjykimit.
- Besimi në kader (caktimin e Allahut).

1. Besimi në Allahun përfshin katër çështje:

- Besimi në ekzistimin e Allahut.
- Besimi se Ai është Zoti dhe Sunduesi.
- Besimi se vetëm Ai meriton adhurimin.
- Besimi në emrat dhe cilësitë e Tij.

2. Besimi në melekë përfshin katër çështje:

- Besimi në ekzistimin e melekëve.
- Besimi në melekët që i njohim me emra, sikurse Xhibrili, dhe besimi në mënyrë të përgjithshme në melekët që nuk ua dimë emrat.
- Besimi në cilësitë e tyre që i dimë.
- Besimi në veprat e tyre që i dimë, të cilat i bëjnë me urdhrin e Allahut.

3. Besimi në Librat e zbritur përfshin katër çështje:

- Besimi se ata janë vërtet të zbritur nga Allahu.
- Besimi në emrat e librave që i njohim me emra, siç janë Kurani, Teurati dhe Inxhili.
- Besimi i tregimeve që thuhet në këta libra, sikurse tregimet e Kuranit dhe tregimet e pashtrembëruara të Librave të mëparshëm, të cilat janë përcjellë në sheriatin tonë.
- Besimi në normat e pashfuqizuara të këtyre Librave dhe po ashtu pajtimi me to dhe dorëzimi ndaj tyre, pa marrë parasysh a e dimë urtësinë a nuk e dimë atë dhe besimi se Kurani ka shfuqizuar të gjithë Librat e mëparshëm.

4. Besimi në të dërguarit e Allahut përfshin katër çështje:

- Besimi se ata janë vërtet të dërguar nga Allahu dhe se kushdo që e mohon ndonjë të dërguar është sikur t'i mohonte të gjithë të dërguarit.
- Besimi me emra në ata të dërguar që përmenden me emra, siç janë: Muhamedi, Ibrahim, Musa, Isa, Nuhu e kështu me radhë (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi ta).
- Besimi në lajmërimet e tyre autentike.
- Zbatimi i kushtetutës së peygamberit të dërguar te ne, që është Muhamedi (sal-lallahu alejhi ue sel-lem), vula e peygamberëve, i cili është i dërguar te të gjithë njerëzit.

5. Besimi në Ditën e Gjykimit përfshin tri çështje:

- Besimi në ringjallje.
 - Besimi në llogaridhënie dhe shpërblim.
 - Besimi në Xhenet dhe Xhehenem.
- Besimi në Ditën e Gjykimit përfshin gjithashtu besimin në çdo gjë që do të ndodhë pas vdekjes, ku bëjnë pjesë edhe sprova e varrit dhe ndëshkimi e shpërblimi në varr.

6. Besimi në kader përfshin katër çështje:

- Besimi se Allahu e ka ditur çdo gjë në mënyrë të hollësishme.
- Besimi se Allahu e ka shkruar këtë në "Pllakën e Ruajtur" që në arabisht quhet "El-Leuh el-Mahfudh".
- Besimi se asgjë nuk ekziston pa vullnetin e Allahut të Madhërishëm.
- Besimi se çdo gjë që ekziston është krijuar nga Allahu, duke përfshirë qeniet, cilësitë dhe lëvizjet e tyre.

Argumenti për gjashtë shtyllat e imanit:

- Thënia e Allahut: **"Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët."** [Kuran: 2, 177]
- Thënia e Allahut: **"Vërtet, Ne çdo gjë e kemi krijuar me kader (masë të paracaktuar)."**

[Kuran: 54, 49]

3. Argument nga suneti kemi hadithin e Xhibrilit, alejhis-selam, kur e pyeti Xhibrili Pejgamberin, sal-lallahu alejhi ue sel-lem, duke thënë: *"Më trego për imanin."* Ai tha: *"Imani është të besosh Allahun, melekët e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij, Ditën e Gjykimit dhe të besosh se Allahu ka caktuar çdo gjë, qoftë e mirë a e keqe."* [Muslimi]

Marrë nga libri "Et-Teuhjd el-mujesser" i autorit Abdullah El-Huvejl
Përktheu: Jusuf Kastrati – Shembulli.com